REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

# VENDIM

**Nr.** 25 **, dt.** 22.12.2023

***MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2024***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise" i ndryshuar Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit "Për buxhetin e vitit 2024", të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, Vendimit të Këshillit të Qarkut "Mbi miratimin e tavaneve përfundimtare dhe Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2024-2026 për Këshillin e Qarkut", VKM nr. 673 dt. 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publike", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

**V E N D O S I**

1. Të miratojë Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024 si më poshtë:

| | | | |
|---|---|---|---|
| ***Të ardhurat e Këshillit të Qarkut gjithsej*** | | ***213.4*** | ***milion lekë*** |
| Nga kjo | - Transferta e pakushtëzuar | 76.04 | milion lekë |
| | - Transferta e kushtëzuar | 8.95 | milion leke |
| | - Të ardhurat vendore | 23.4 | milion lekë |
| | - Te ardhura nga fondet e Programeve të BE | 67 | milion leke |
| | - Të ardhura të trashëguara nga viti 2023 | 38 | milion lekë |
| ***Shpenzimet e Këshillit të Qarkut gjithsej*** | | ***213.4*** | ***milion lekë*** |
| Nga kjo | Funksionet e veta | | |
| | - Për administratën e Këshillit të Qarkut | 28.6 | milion lekë |
| | - Për shpërblimin e antarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut | 1.2 | milion lekë |
| | - Për investime në Këshillin e Qarkut | 88.9 | milion lekë |
| | - Kontribut bashkëfinancim në Proj. BE | 50 0 | milion lekë |
| | - Projekti STEP | 0.2 | milion leke |
| | - Për fond rezerve | 4.4 | milion lekë |
| | - Funksionet e deleguara DAMT | 8.95 | milion lekë |

***Mbeshtetja per zhvillim ekonomik***

| | |
|---|---|
| - Mbeshtetje perr ICTs | 3 milion lekë |
| -Projekti: "Mbështetje për të Rinjtë në Bujqësi - 20 Bletërritës të Rinj" | 3 milion lekë |
| -Projekti: "Organizimi dhe Mbështetje të Rinjve në Turizëm 15 Guida Turistike për Rajonin" | 2.2 milion lekë |
| - Konferenca shkencore për prioritetet e zhvillimit te Qarkut | 0.8 milion lekë |
| - Prezantimi i Produktit Turistik në Philoxenia | 0.9 milion lekë |
| - Prezantimi i Produktit Turistik në Panairin e Turizmit në Prishtinë | 0.8 milion lekë |
| - Bleterritesit Aktivitet shkencor dhe panair | 0.8 milion lekë |
| - Projekti: "Studentet ne sipermarrje e lire" "Student in Free Enterprise | 0.8 milion lekë |

**Përkujdesi social**

| | |
|---|---|
| - Mbeshtetja per transportin rrethqytetes per te rinjte | 6.0 milion lekë |
| - Projekte sociale me Bashkite e qarkut "Mosha e trete" dhe"Femijet e Komuniteteve" | 6.0 milion lekë |
| - Projekti "Karta e studentit" | 0.95milion lekë |
| - Te verberit | 0.41milion lekë |
| - Merry poter | 0.4 milion lekë |
| - Qendra rezidenciale | 0.15milion lekë |

**Trashëgimia kulturore**

| | |
|---|---|
| - Aktivitete kulturore locale | 0.84 milion lekë |
| - Projekti: "Olimpiadat e Shkencave për Shkollat e Mesme të Qarkut Korçë" | 0.8 milion lekë |
| - Festivali Folklorik "Autonom Fest" | 0.8 milion lekë |
| - Te rinjte ne folk | 0.2 milion lekë |
| - Projekti: "Nxitja e Sipërmarrjes në Artizanat dhe Produktet tradicionale në Shkollat e Mesme Profesionale' | 0.95milion lekë |
| - Konferenca shkencore "Korca nga Lufta e Pare Boterore ne veteqeverim" | 0.3 milion lekë |
| - Konference shkencore: "80 Vjetori i Clirimit, Shqiptaret dhe koalicioni antifashist" | 0.3 milion lekë |
| - Projekti: "Rinshow Qarku Korce | 0.6 milion lekë |
| - Ekspozita e Koleksionistëve "Krahina Autonome e Korçës | 0.12 milion lekë |
| - Pergatitja per botim e librit "Deshmoret e Atdheut të Qarkut Korçë | 0.1 milion lekë |

2. Të miratojë nivelin e tarifave të shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut për komunitetin në funksion të realizimit të detyrave të tij mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi sipas pasqyrës bashkangjitur.

3. Të miratojë limitin e përdorimit të karburantit për automjetet e Këshillit të Qarkut deri ne 1000 litra në muaj, por brenda fondit limit për blerje karburanti të miratuar për vitin 2024.

4. Të miratojë limitin e përdorimit telefonisë celulare për vitin 2024 brenda mases 2% te shpenzimeve për mallra dhe shërbime si më poshtë:
   - Kryetar i Këshillit të Qarkut limiti mujor 4000 lekë

5. Të miratojë pasqyrat e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024, të cilat i bashkangjiten këtij vendimi.

6. Në rast të lindjes të nevojës për ndryshime në buxhet dhe rishperndarje te fondeve buxhetore, do të zbatohet neni 44, paragrafi i dyte, pikat a,b,c dhe ç të ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i cili citon se: *Për njësitë e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet në nivel programi: a) rishpërndarjet ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore; b) rishpërndarjet e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore; c) rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore; ç) rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese, miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore, nga e cila varet njësia shpenzuese.*

7. Projektet e investimeve në sektorin e turizmit në bashkepunim me bashkitë( raporti 60% me 40%) dhe Projektet e studimit ne bashkepunim me bashkitë (raport 70% me 30%), do të fillojnë të zbatohen vetëm pasi Bashkia përkatëse të ketë derdhur pjesën e saj takuese të fondit si kontribut për Këshillin e Qarkut.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit në Këshillin e Qarkut, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit Korcë.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 01 janar 2024.

**Kryetari i Këshillit të Qarkut**

**Erjon NEXHIPI**

**Konceptoi O.Beqiraj**
**Juristi Gj. Kristo**
**Sek.K.Qarkut B. Muço**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KORCE